



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË LËNDËS PSIKOLOGJI 2019

1. HYRJE

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të psikologjisë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), për t'u ardhur në ndihmë të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve, si dhe të gjithë mësuesve të lëndës së psikologjisë për t'u përgatitur për marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MASR-JA ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumente zyrtare¹, të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore - edukative;
- programi përkatës lëndor;
- aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë në mësimdhënie-nxënie;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës së psikologjisë, sipas programit lëndor përkatës.

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASR-së që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të psikologjisë është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të tyre. Programi është hartuar nga grupi i punës duke mbajtur parasysh përmbushjen e dy qëllimeve kryesore:

- *Së pari*, të ofrohet si një program orientues për t'u ardhur në ndihmë Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve, si dhe të gjithë mësuesve të lëndës së psikologjisë së arsimit parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese në bazë rrethi. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete.
- *Së dyti*, ai të ofrohet si një program i detyruar, veçanërisht për mësuesit që këtë vit do të marrin shkallët e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje gjithëvjetore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi synon:

- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- rritjen e aftësive dhe kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor, drejt një mësimdhënieje të suksesshme;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe të komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkimore të shqipes;
- realizimin në praktikë nëpërmjet demonstrimit konkret të aftësive të fituara, e në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

Objektivat afatshkurtër e programit:

Programi synon që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor dhe veçanërisht rrishtë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat profesionale për të rritur efektivitetin e procesit mësimor dhe për të realizuar një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e metodave për menaxhimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave të reja të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe të ligjësive shkencore të lëndës, si dhe në zbatimin e tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe veçoritë e klasave ku japin mësim;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe të komunikimit në punën e tyre në shkollë.

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të psikologjisë është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër, për të cilat testohen mësuesit. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës së psikologjisë që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Programi është ndërtuar duke pasur si pikënisje standardet bazë të përgjithshme të mësuesit, si dhe në standardet e mësuesit të lëndës së psikologjisë. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij, si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat që mësuesit duhet të zotërojnë në fushën e njohurive dhe aftësive, si dhe literatura përkatëse rekomanduese që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE

Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë:	Literatura
<ul style="list-style-type: none">• të interpretojë legjislacionin shkollor parauniversitar;• të zbatojë legjislacionin shkollor dhe udhëzimet e MASR-së;• të përshkruajë dokumentacionin shkollor të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit mësimor-edukativ në të gjitha hallkat e tij;• të tregojë lidhjen dhe rëndësinë e dokumentacionit shkollor për zbatimin e politikës arsimore në shkollë.• të vlerësojë risitë e dokumentacionit që po shqyrton;• të realizojë kuptimin, zbërthimin dhe përgjegjshmërinë në zbatimin e kërkesave të dokumentacionit shkollor;	<ul style="list-style-type: none">• Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.• Udhëzimi nr.27, datë 16.08.2018 “Për vitin shkollor 2018-2019 në sistemin arsimor parauniversitar”.• Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.• Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.• Udhëzimi nr. 2, datë 12.02.2015. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.• Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”.• Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”.• Urdhri Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e

	nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”.
FUSHA: PROGRAME LËNDORE	
Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë:	Literatura
<ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë çfarë mësuesit duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë për nxënësit; • të analizojë karakterin konkret dhe të qartë të përmbajtjes së kurrikulës; • të vlerësojë zbatimin cilësor të programit: kërkesat ndaj mësuesit si zbatues i programit lëndor; • të vërë në dukje te rishikimi i programit lëndor: kërkesat ndaj mësuesit si nismëtar i ndryshimit ose përmirësimit të programit lëndor; • të dallojë strukturën e programit lëndor dhe të përshkruajë përmbajtjen e rubrikave të saj; • të përshkruajë lidhjet ndërmjet njohurive të lëndës që jep mësim me njohuritë e disiplinave të tjera që zhvillohen në shkollë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza kurrikulare, 2014. • Programi i lëndës “Psikologji” për gjimnazin, për arsimin profesional dhe për arsimin e orientuar (social – kulturor). • Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016. • Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat X -XII.
FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE TË METODOLOGJISË NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE	
Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë:	Literatura
<ul style="list-style-type: none"> • të zhvillojë mësimdhënie në përshtatje me synimet dhe objektivat konkrete të lëndës që jep; • të zhvillojë koncepte dhe metoda që e bëjnë 	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017

<p>nxënësin të aftë për të zbatuar njohuritë e reja;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të jetë i hapur për bashkëpunim dhe vlerësim të punës që bën; • të dallojë pyetjet e hapura dhe të mbyllura, të strukturuar dhe gjysmë të strukturuar. • të hartojë objektiva të nxënit; • të dallojë dhe të hartojë objektiva arritjeje në nivele të ndryshme; • të zbatojë njohuritë e tij për krijimin e një klime të përshtatshme të mësuarit në klasë; • të dallojë dhe të përzgjedhë metoda dhe teknika të përshtatshme me objektivat e të mësuarit dhe stilet e ndryshme të të mësuarit; • të strukturojë një ditar dhe të tregojë qëllimin e rubrikave të tij; • të përcaktojë synimet ose objektivat e m kurrikulës në përputhje me filozofinë arsimore të përzgjedhur; • të alternojë metodat e punës individuale dhe asaj në grup në varësi të objektivave të të mësuarit; • zbaton teknika dhe forma të ndryshme të vlerësimit të nxënit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016. • Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA 2016. • Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij. • Të nxënit me situata, kompetenca dhe situata e të nxënit, IZHA 2014. • Portofoli i të nxënit, IZHA 2015.
---	---

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

<p align="center">Rezultati</p> <p align="center">Mësuesi do të jetë i aftë:</p>	<p align="center">Literatura</p>
<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë parimet themelore mbi të cilat është hartuar kodi i etikës së mësuesit; 	<ul style="list-style-type: none"> • Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar.

<ul style="list-style-type: none"> të dallojë sjelljet e mësuesit që burojnë nga parimet themelore; të hartojë vetë një kod të thjeshtë sjelljeje që bazohet në parimet dhe standardet e kodit të etikës; të përshkruajë sjelljet model që duhet të karakterizojnë zbatuesit e kodit të etikës së mësuesit, në varësi të funksionit që ka në komunitetin e shkollës; të marrë vendime në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit. Draft Standardet profesionale të mësuesit në arsimin parauniversitar, IZHA 2016.
---	--

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Rezultati	Literatura
Mësuesi do të jetë i aftë:	
<ul style="list-style-type: none"> të njohë rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; të zbatojë rregullat e drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Nr.	Tematika	Rezultatet e pritshme	Literatura
1.	Studimi i psikologjisë	<ul style="list-style-type: none"> të dallojë këndvështrimet e sotme të psikologëve për kuptimin e sjelljes dhe të proceseve mendore; të përshkruajë nënfushat kryesore të psikologjisë; të tregojë veçorinë e psikologjisë në studimin e sjelljes dhe të proceseve mendore; të përshkruajë zhvillimin e psikologjisë, si një 	Tekstet e psikologjisë së shkollës së mesme si dhe tekste dhe materiale për mësuesin.

		<p>shkencë empirike;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojë rëndësinë e funksionimit psikologjik në jetë; • të shpjegojë rëndësinë e mirëqenies shpirtërore dhe të kujdesit që i duhet kushtuar kësaj. 	
2.	Biopsikologjia	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë strukturën dhe funksionim e neuronit; • të përshkruajë organizimin e sistemit nervor; • të përshkruajë teknologjitë dhe metodat klinike të studimit të trurit; • të përshkruajë strukturën dhe funksionimin e sistemit endokrin; • të shpjegojë bashkëveprimin e trashëgimisë me mjedisin në lidhje me sjelljen; • të shpjegojë perceptimin dhe bashkëveprimin e personit me mjedisin; • të analizojë rolin e biologjisë dhe të të nxënit në motivacionin dhe emocionet; • të përshkruajë teoritë kryesore për motivacionin; • të analizojë aspektet fiziologjike, afektive, kognitive dhe sjellore të emocioneve; • të shpjegojë reagimet fiziologjike dhe psikologjike ndaj stresorëve; • të vlerësojë rëndësinë e kujdesit për funksionimin mendor; • të vlerësojë veprime për përmirësimin e shëndetit mendor; • të vlerësojë nevojën për përmirësimin e funksionimit mendor; • të vlerësojë plane për përballimin e stresit personal. 	

3.	Zhvillimi	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë zhvillimin si proces jetësor; • të tregojë teknikat për grumbullimin e të dhënave për zhvillimin njerëzor; • të përshkruajë teoritë për zhvillimin njerëzor • të diskutojë për temat më të mëdha lidhur me zhvillimin: rolin e mjedisit e trashëgimisë, vazhdimësinë/ ndërprerjes së zhvillimit, qëndrueshmërinë/paqëndrueshmërinë e zhvillimit, zhvillimin në periudha kritike; • të diskutojë për teoritë për kuptimin e personalitetit; • të përshkruajë mjetet në përdorim për vlerësimin e personalitetit; • të vlerësojë periudhën personale të zhvillimit dhe rëndësinë që ka ajo për jetën; • të mbajë qëndrime të mirinformuara në lidhje me krizat e moshës së vet; • të zhvillojë sjellje të shëndetshme në lidhje me substancat, seksin, ushqimin; • të ndërtojë plane për zhvillimin e personalitetit individual. 	
4.	Njohja	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë kuptimin dhe parimet e të nxënit; • të rendisë pjesët përbërëse të të mësuarit kognitiv; • të flasë për rolin e biologjisë dhe të kulturës në procesin e të nxënit; • të përshkruajë mënyrën si bëhet regjistrimi dhe përdorimi i informacionit të kujtesës; • të përshkruajë sistemet e kujtesës afatshkurtër e afatgjatë • të analizojë metodat e përmirësimit të kujtesës; • të diskutojë për strategjitë dhe pengesat për zgjidhjen 	

		<p>e problemeve dhe marrjen e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • të rendisë tiparet strukturore të gjuhës; • të përshkruajë teoritë dhe stadet e zhvillimit të gjuhës; • të shpjegojë lidhjet ndërmjet të menduarit dhe gjuhës; • të përshkruajë natyrën e ndërgjegjes; • të përshkruajë karakteristikat dhe teoritë e gjumit, të ëndrrave dhe të hipnozës; • të përshkruajë drogat psikoaktive dhe rolin e tyre në psikikë; • të tregojë pse dhe si maten veçoritë individuale; • të analizojë marrëdhëniet ndërmjet trashëgimisë dhe mjedisit në diferencat individuale; • të përshkruajë natyrën e inteligjencës dhe si testohet ajo; • të zhvillojë plane individuale për përmirësimin e kujtesës dhe të të menduarit; • të zgjidhë probleme mbi bazën e njohurive të fituara. 	
5.	Variacionet mes individëve e grupeve	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë karakteristikat dhe origjinën e sjelljes anormale; • të rendisë metodat e përdorura për studimin e sjelljes anormale; • të shpjegojë kategoritë kryesore të sjelljes anormale; • të përshkruajë metodat më të shquara për trajtimin e sjelljes anormale; • të tregojë kush i trajton çrregullimet e sjelljes; • të diskutojë për aspektet etike të trajtimit të sjelljes 	

		<p>së çrregulluar;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të mbajë qëndrimin e tij për gjykimin social dhe qëndrimet shoqërore; • të përshkruajë kategoritë shoqërore dhe kulturore; • të analizojë ndikimin shoqëror dhe marrëdhëniet shoqërore; • të dallojë sjellje të shëndetshme mendore; • të vlerësojë shëndetin mendor; • të zhvillojë sjellje jostigmatizuese ndaj personave me shqetësime mendore; • të vlerësojë rolin e psikologut dhe të psikiatrit; • të demonstrojë qëndrime tolerance dhe joparagjyquese në jetën personale. 	
--	--	--	--